

# BULETINI CENS 2020

NR. 1 | TETOR 2018 |



Buletini Informues për Cens-in 2020 është një pasqyrë e aktiviteteve kryesore që INSTAT po ndërmerr dhe do të ndërmarrë deri në përfundim të kësaj projekti. Ai do të shpërndahet me një frekuencë tremujore

## CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka planifikuar të kryejë Cens-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2020. Censi i Popullsisë dhe Banesave 2020 do të ndjekë metodën e numërimit të drejtpërdrejtë universale bazuar në operacionet në terren me përpilimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur metoda të reja për mbledhjen e të dhënave.

### Kontaktet:

Delina Ibrahimaj, Drejtore e Përgjithshme e INSTAT  
[DIbrahimaj@instat.gov.al](mailto:DIbrahimaj@instat.gov.al)

Alban Çela, Drejtues i Njësisë IPA  
[ACela@instat.gov.al](mailto:ACela@instat.gov.al)

Gladiola Baja, Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit të Projekteve  
[GBaja@instat.gov.al](mailto:GBaja@instat.gov.al)

Klajd Shuka, Përgjegjës për Zbatimin Operacional të Projektit  
[KShuka@instat.gov.al](mailto:KShuka@instat.gov.al)

Helda Mitre, Përgjegjës për Zbatimin Teknik të Projektit  
[HMitre@instat.gov.al](mailto:HMitre@instat.gov.al)

Altin Xhikneli, Përgjegjës për Komunikimin  
[AXhikneli@instat.gov.al](mailto:AXhikneli@instat.gov.al)

Instituti i Statistikave  
Rr. Vllazën Huta,  
Ndërtesa 35, Hyrja 1  
Tiranë, Kodi Postar 1017

[Cens2020@instat.gov.al](mailto:Cens2020@instat.gov.al)  
[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)  
Tel: +355 4 2222 411  
Faks: +355 4 2222 411

## PËRMBAJTJA

Cens-i Popullsisë dhe  
Banesave 2011 dhe risitë  
e Cens-it 2020

### Menaxhimi i Projekteve

- Ndërtimi i Strategjisë së aktiviteteve të Cens-it 2020
- Hartimi i Pyetësorit të Cens-it 2020
- Hartimi i ligjit të Cens-it 2020

### Financimi nga Donatorët

- Buxheti i Shtetit
- Bashkimi Evropian
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida)
- Donatorë të tjerë



## Cens-i i Popullsisë dhe Banesave 2011 dhe risitë e Cens-it 2020


INSTAT ka zhvilluar me sukses Cens-in e fundit të Popullsisë dhe Banesave në Tetor të vitit 2011. Në Dhjetor të vitit 2011 publikoi rezultatet paraprake ndërsa në Dhjetor të vitit 2012 publikoi Rezultatet Finale, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013 publikoi rezultatet sipas Qarqeve si dhe në Maj të vitit 2014 publikoi Analizat e Thelluara të Cens-it 2011;

Buxheti i akorduar për Cens-in 2011 ishte 16.7 milion Euro.

Më 1 tetor 2011 popullsia banuese e Shqipërisë ishte 2.821.977 banorë. Vihet re një rënie në numrin e popullsisë afërsisht prej 8,0 % në krahasim me Cens-in e vitit 2001, ku popullsia e numëruar ishte 3.069.275 banorë.

Për Cens-in 2020, INSTAT do të përdorë metodën tradicionale, derë-më-derë, përmes intervistave me pyetësorë, por ndryshe nga Cens-i 2011 i cili u zhvillua me pyetësorë letër, në 2020 do të përdoren tableta.

## Ecuria e planit të aktiviteteve



## Ndërtimi i Strategjisë së Cens 2020

### Struktura

Në përputhje me Strategjinë e Censit 2020, ndërtuar me asistencën e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), si dhe me qëllim realizimin me sukses të tij, INSTAT ka ngritur Strukturën organizative të Censit. Gjithashtu janë ngritur dhe përcaktuar grupet e punës që do të ndjekin zbatimin e projektit. Me qëllim zbatimin e aspekteve teknike të projektit është vënë në funksion Njësia IPA e cila është përgjegjëse për programimin, zbatimin dhe monitorimin e projektit.

## Hartimi i Pyetësorit të Cens 2020

INSTAT  
Instituti i Statistikave

DRAFT-PYETËSORI I  
CENSIT TË POPULLSISË  
DHE BANESAVE 2020

INSTAT, gjatë punës për përgatitjen e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020, testoi draft-pyetësorin. Testimi kishte të bënte me çështje metodologjike si zbatimi i definicioneve bazë, kuptueshmëria e përmbajtjes së pyetësorit, evidentimi i pyetjeve të vështira për t'u kuptuar nga intervistuesi dhe i intervistuari, si dhe kohëzgjatja për plotësimin e pyetësorit për një NjEF.

Numri i pyetësorëve që u plotësuan nga punonjësit e INSTAT u organizua si më poshtë vijon:

- 10 pyetësorë për secilën nga Drejtoritë prodhuese;
- 5 pyetësorë për secilën nga Drejtoritë e tjera;
- 10 pyetësorë për secilën nga Zyrat rajonale;

Draft-Pyetësori është ndërtuar konform rekomandimeve ndërkombëtare dhe rregulloreve të Bashkimit Evropian, udhëzimeve të "Recommendations for the 2020 Censuses of Population and Housing of the Conference of European Statisticians" si dhe rekomandimeve të Eurostat-it dhe OKB.

Pyetësori i "Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020" është i ndarë në dy shtylla kryesore: Pyetje të detyrueshme, të cilat kanë një interes të përbashkët dhe janë të nevojshme për krahasime statistikore në nivel ndërkombëtar; dhe Pyetje jo të detyrueshme, të cilat janë opsionale dhe janë të nevojshme në varësi të situatës dhe kërkesave specifike të vendit.

Për hartimin e pyetësorit të Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020 janë zhvilluar disa takime konsultative me aktorë kombëtar dhe ndërkombëtar.

### Organizimi i dy tryezave të rumbullakëta:



Në datë 14 Qershor 2018, me mbështetjen e UNICEF, INSTAT organizoi takimin e parë konsultativ mbi Pyetësorin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, ku u diskutua me aktorë të interesuar, lista e çështjeve thelbësore dhe jo thelbësore për t'u përfshirë në pyetësor. Këto çështje janë pjesë e rekomandimeve të Eurostat dhe Kombeve të Bashkuara mbi raundin e censuseve të Popullsisë dhe Banesave 2020. Aktorë të ndryshëm shprehën interesat e tyre specifike në lidhje me çështjet e prezantuara si aftësia e kufizuar, migracioni, grupi etnik etj.

Në datë 26 Shator 2018, në ambientet e INSTAT u organizua tryeza e dytë konsultative mbi draft pyetësorin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i përmbajtjes së draft pyetësorit të Censit 2020 me përfaqësues të pushtetit vendor, për të marrë sugjerimet dhe komentet e tyre mbi përmbajtjen e tij. Gjithashtu gjatë kësaj tryeze konsultative u mbajt dhe një prezantim mbi rolin që do të ketë pushteti vendor në organizimin dhe mbarëbajtjen e procesit të Cens-it 2020. Ky takim do të jetë edhe pikënisja e bashkëpunimit të frytshëm midis INSTAT dhe pushtetit vendor në kuadër të këtij procesi madhor statistikor.



## Hartimi i Ligjit të Cens 2020

INSTAT  
Republika e Shqipërisë  
Instituti i Statistikave

Projektligji për Censin e Popullsisë dhe Banesave është përgatitur nga INSTAT falë asistencës së Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), duke marrë parasysh mendimet dhe sugjerimet e ministrive dhe institucioneve të tjera publike. Aktualisht projektligji i është dërguar qeverisë për propozim në Kuvend.

INSTAT ka publikuar në faqen e internetit [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) dhe në portalin e Konsultimit Publik Projektligjin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020.

Faqja e internetit të INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/censi-i-popullsis%C3%AB-dhe-banesave-2020-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/>

Portali i Konsultimeve Publike: <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/81>




Regjistri Elektronik për Njoftimet  
dhe Konsultimet Publike

## Plani i Aktiviteteve

Në kuadër të procedurave të tenderimit për Grantin e Censit 2020, në datë 25 Tetor 2018 në gazetën ndërkombëtare "The Economist" u bë shpallja e njoftimit për Kontratën e Shërbimit "Mbështetje për Zbatimin e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2020". Në datë 27 Nëntor 2018 është afati për dërgimin e dokumentave për kompanitë të cilat janë të interesuara të aplikojnë për Kontratën e Shërbimit. Pas kësaj do të vazhdojë procedura e përzgjedhjes së kompanisë, procedure e cila zgjat 6-8 muaj. <http://www.instat.gov.al/media/4820/mb%C3%ABshtetje-p%C3%ABr-zbatimin-e-censit-t%C3%AB-popullsis%C3%AB-he-banesave-2020-n%C3%AB-shqip%C3%ABri.pdf>

## Buxheti i Cens-it 2020, Financimi nga Donatorët

Cens-i ardhshëm i Popullsisë dhe Banesave që pritet të realizohet në vitin 2020 ka një kosto prej 15.8 million €.



Buxheti i Shtetit ka ndërmarrë angazhimin që të financojë Projektin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020 me 52 % të totalit.

Bashkimi Evropian ka ndërmarrë angazhimin për të mbështur Cens-in me 31 % të totalit

Censi 2020 do të shërbejë si bazë për kalimin nga metoda tradicionale drejt metodave të bazuara në regjistra pas vitit 2021. Mbështetja e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) do të sigurojë që elementet e nevojshëm për ngritjen e regjistrave statistikor, të inkuorohen dhe të testohen në terren, duke përfshirë edhe Cens-in Pilot. Në kuadër të planit të aktiviteteve të CENS 2020 për vitin 2018, me mbështetjen e SDC nëpërmjet projektit SALSTAT po kontribuon aktualisht në aktivitetet e Censit me testimin e

procesit të përditësimit të informacionit gjeografik (hartave Cens-it) nëpërmjet përdorimit të metodave të reja në mbledhjen e të dhënave në terren si dhe identifikimin e elementëve të përbashkët me regjistrat administrativ ekzistues. SDC do të mbështesë projektin e Cens-it me 4 % të totalit.

Donatorë të tjerë do të mbështesin projektin me 13 % të totalit. Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida), ka dhënë koontributin e saj për blerjen e serverave që do të shërbejnë për Cens-in e Popullsisë dhe Banesave 2020. Gjithashtu jemi në bisedime për mbështetjen që mund të japë gjatë implementimit të këtij projekti. Ambasada Franceze do të mbështesë përgatitjen e analizës së risqeve. UNFPA ka planifikuar pajisjen me tableta për GIS.

## Aktivitetet në vijim

12 Nëntor 2018 Tryezë konsultative me Komunitetet Fetare	16 Nëntor 2018 Njësia e Gjeoinformacionit për Cens 2020 - Planifikimi i shpërndarjes së stafit me kontratë sipas zonave në të gjithë territorin e vendit
19 Nëntor 2018 Tryezë konsultative për personat me aftësi të kufizuara	01 Dhjetor 2018 – 15 Dhjetor 2018 Njësia e Gjeoinformacionit për Cens 2020 - Përgatitja dhe shpërndarja e infrastrukturës dhe materialeve mbështetëse të përditësimit në terren
05 Dhjetor 2018 Tryezë konsultative me Minoritetet	12 Nëntor 2018 Njësia e Gjeoinformacionit për Cens 2020 - Specifikimi i kriterëve për përzgjedhjen e stafit me kontratë
01 Dhjetor 2018 – 15 Dhjetor 2018 Njësia e Gjeoinformacionit për Cens 2020 - Përgatitja e udhëzuesve dhe manualeve të punës për përditësimin në terren	15 Dhjetor – 31 Dhjetor Njësia e Gjeoinformacionit për Cens 2020 - Organizimi dhe realizimi i trajnimit të anketuesve
01 Shtator – 31 Dhjetor Njësia e Gjeoinformacionit për Cens 2020 - Finalizimi i pyetësorit të përditësimit të hartave	Miratimi i projektligjit